

Stamboll - 4Dite (O-ETR-109)**Shteti:** Turqi**Kategoria Ofertes:** Stamboll 4 Dite, 29Prill, 1,8,15,22Maj, 199€**Emri Hotelit:** Standart - 4 Yje**Tipi Ofertes:** Mëngjes**Kohezgjatja:****Nisja:****Transporti:** Avion**Cmimi:****Stamboll - 4 Dite** Nisje më 29 Prill, 1, 8, 15, 22 Maj**Dita e Parë:**

Paraqitja në Aeroportin e Rinasit duhet të bëhet 1 orë e 30 minuta para nisjes së avionit.

Fluturimi për në Stamboll.

Nisja në 09.20 te mensesit. Mbritja në Stamboll në 12.00.

Transferata nga aeroporti në Hotel Aspen.

Nisja në këmbë me Shoqëruesin për në Pazarin e Vjetër Kapali Carchi.

Pazari i Vjetër Kapali Carshi është një nga tregjet e mbulura më të mëdha në botë. Ka 61 rrugë të mbuluara dhe mbi 4 mijë dyqane në një zone prej 30.700 m² dhe që tërheq rreth 250 mijë deri 400 mijë vizitorë në ditë.

Hyrja Falas – Qëndrimi rreth 2 orë.

Pas vizitës në Pazar, nisja me autobus për në Dolma Bahce.

Pallati Dolma Bahce, apo Sarajet Verore të Sulltanit, apo Pallati i Kopshteve të Mbushura është ndërtuar ndërmjet viteve 1843 – 1856 dhe ka kushtuar rreth 35 ton ar e barabartë me rreth 1.5 miliard USD. U ndërtua nga Sulltani I 31 i Perandorisë Otomane Abdulmecid I për të kaluar luksin dhe komfortin e asaj kohe që kishin mbretëritë në Europë.

Hyrja 10 Euro – Qëndrimi 1 orë.

Pas vizitës, kthimi dhe Sistemimi në Hotel, Sistemimi në Hotel.

Fjetje në Hotel.

Dita e Dytë:

Mëngjesi në Hotel.

Nisja me Autobus për në Akuarium.

Akuariumi i Stambollit është hapur në Prill 2011 dhe është një ndër më të mëdhenjtë në botë për nga vëllimi, shumëllojshmëria e specieve të ujit dhe aktiviteteve.

Hyrja 14 Euro – Qëndrimi 2 orë.

Vazhdohet në Top Kapi, Sarajet Dimërore të Sulltanit.

Pallati Topkap? në shekujt 15 dhe 16 ka shërbyer si vendbanimi kryesor dhe selia administrative e sulltanëve osmanë. Ndërtimi i urdhëruar nga Sulltan Mehmet Pushtuesi, filloi në 1459, gjashtë vjet pas pushtimit të Kostandinopojës. Topkap? fillimisht u quajt "Pallati i Ri" (Yeni Saray) për ta dalluar atë nga "Pallati i Vjetër" (Eski Saray) në Sheshin Beyaz?t. Kompleksi i pallatit përbëhet nga katër oborre kryesore dhe shumë ndërtesa më të vogla. Anëtarët femra të familjes së Sulltanit jetonin në harem dhe zyrtarët kryesorë të shtetit, përfshirë Vezirin e Madh, zhvillonin takime në ndërtesën e Këshillit Perandorak.

Hyrja 13 Euro – Qëndrimi 2 orë.

Vazhdon Vizita në Xhaminë Blu.

Xhamia Sulltan Ahmet, e njohur gjithashtu si Xhamia Blu, projektuar nga Arkitekt Shqiptar Sinani është xhamia e epokës Osmane ndërtuar midis 1609 dhe 1616 gjatë sundimit të Ahmet I. Xhamia Blu kombinon shumë elemente bizantine të Shën



Sofisë fqinje me arkitekturën tradicionale islamike dhe konsiderohet të jetë xhamia e fundit e madhe e periudhës klasike.

Hyrja Falas – Qëndrimi 30 Minuta

Vazhdon Vizita në Shën Sofi Sofi – Hagia Sofia

Hagia Sophia, zyrtarisht Xhamia e Madhe e Hagia Sophia dhe më parë Kisha e Shën Sofisë, është ndërtuar në vitin 537 si katedrale patriarkale e kryeqytetit perandorak të Kostandinopojës, ishte kisha më e madhe e krishterë e Perandorisë Romake Lindore (Perandoria Bizantine) dhe Kisha Ortodokse Lindore, përveç gjatë Perandorisë Latine nga 1204 deri në 1261, kur u bë katedralja katolike romake e qytetit. Në 1453, pas Rënies së Konstandinopojës në Perandorinë Osmane, ajo u shndërrua në një xhami. Në vitin 1935 Republika laike Turke e themeloi atë si një muze. Në vitin 2020, ajo u rihap si xhami.

Hyrja Falas – Qëndrimi 30 Minuta

Vazhdon Vizita në Hipodrom

Hipodromi i Kostandinopojës ishte qendra sportive dhe shoqërore e Kostandinopojës, kryeqyteti i Perandorisë Bizantine. Sot është një shesh me emrin Sultanahmet Meydani, me disa fragmente të strukturës origjinale të mbijetuar.

Kthimi në Hotel.

Në mbrëmje, Nisja për në Kroçiere për Shëtitje në Bosfor gjatë Natës, Darkë me Pije pa limit dhe Shfaqje Tradicionale dhe Moderne Turke.

Hyrja 30 Euro – Qëndrimi 3 orë.

Kthimi në Hotel

Fjeje në hotel.

Dita e Tretë:

Mëngjesi në Hotel.

Nisja për në Eminoy, stacioni i anijeve dhe jahteve për në Bosfor.

Lundrim me anije për 2 orë në Ngushticën e Bosforit në drejtim të Detit të Zi për të vizituar pjesën bregdetare të Stambollit, Evropën dhe Azinë, si dhe për të parë nga anija kalanë e vjetër, Rumelitisa.

Hyrja 5 Euro - Qëndrimi 2 orë

Vazhdon udhëtimi drejt Kodrës Camlica

Kodra Çamlıca ndodhet në pjesën aziatike të qytetit në 268 m mbi nivelin e detit dhe ka një pamje panoramike të pjesës jugore të Bosforit dhe grykës së Bririt të Artë. Kodra është një atraksion i njohur për vizitorët. Ka çajtoje, kafene dhe një restorant të dizajnuar historik brenda një parku publik me pemë monumentale, kopshte lulesh dhe shatërvane.

Hyrja e lirë - Qëndrimi 40 minuta.

Vazhdon vizita në Qendrën e Stabollit, në Sheshin Taksim.

Sheshi Taksim, i vendosur në pjesën europiane të Stambollit, është i famshëm për restorantet, dyqanet dhe hotelet. Konsiderohet si zemra e Stambollit modern, me stacionin qendror të rrjetit Metro të Stambollit. Këtu ndodhet dhe Monumenti i Republikës

Kthimi në Hotel Fjeje në hotel.

Fjeje në hotel.

Dita e Katërt:

Mëngjesi në Hotel.

Paradite të lirë.

Të lirë në Qendrën Tregare deri në Transfertën me autobus për në Aeroport. Fluturimi për në Tiranë.

Fluturimi për në Tiranë.

Nisja nga Stambolli në 19:50.

Mbërritja në aeroportin e Rinasit në 20:30.

Kujdes:

Të gjithë klientët që udhëtojnë për në Turqi duhet të kenë pasaportë të vlefshme për 6 muaj duke filluar nga dita e pare e hyrjes ne Stamboll.

Hoteli Aspen 4*

Sauna, Masazh, Banjo Turke dhe Pishinë e Brendshme

Hotel Akgun 5*

Spa & Wellness



Me Shume Detaje: Në pagesë përfshihen:

- Bileta e avionit vajtje – ardhje. (Bagazhe të plota 30 kg + 8 kg bagazh dore).
- Akomodimi në hotel në qendër të pjesës Evropiane të Stambollit
- Mëngjeset për të gjithë ditët e qëndrimit.
- Shëtitjet në Stamboll me autobus (sipas programit)
- Shoqërues dhe guidë shqiptare, për të gjithë ditët e qëndrimit
- Transferrat Aeroport – Hotel – Aeroport

Në pagesë nuk përfshihen:

- Gjithshka që nuk është përmendur në këtë Program
- Siguracioni në Udhëtim
- Hyrjet në Monumente dhe Muzeume

OPSIONALE:

1. Lundrim me anije në Bosfor 1.5 – 2 orë për të parë Europën e dhe Azinë €5.
2. Shtesë për Darkë €30 për 3 netë.
3. Kroçiere me Shfaqje dhe Darkë €30, përfshin: Transporti vajtje ardhje nga Hoteli, Shfaqje me Kërcimtarë dhe DJ, Darkë Speciale, Pije jo alkoolike pa kufizim. Zgjat 3 orë.